



**STATUTI**  
**I SHOQËRISË TREGTARE**  
**“RSN CONSTRUCTION” SHPK**

Sot, në datë 27.05.2020 (dymije e njëzet) mbështetur në kërkesat e ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, si dhe të ligjit Nr 9723 date 03/05/2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, me vullnetin tonë të lire ramë dakord të hartojmë këtë statut të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar (shpk) “RSN CONSTRUCTION”sh.p.k, e cila do të veprojë sipas legjislacionit në fuqi e themeluar nga ortakët si vijon:

**NENI 1**

**Ortakët e shoqërisë**

Shoqëria themelohet nga ortakët:

1. **Ardit RAKIPI**, atesia Karaman, shtetas shqiptar, i lindur me 12.05.1967, ne Peqin, dhe banues në adresën rruga “11 Janari” Peqin, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit numer 035090561 dhe numer personal G70512019G.
2. **Flamur SALIJA**, atesia Zelul, lindur me 16.07.1972, ne Carshove, Permet dhe banues ne Tirane, 1045 Selitë Lagjja nr 13, Rr “Eduart Mano” 38 / 1 / 6, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit numer 028807288 dhe numer personal H20716089I.
3. **Erjon NITO**, atesia Aleksandër, i lindur me 11.11.1983, ne Kutalli, Berat dhe banues ne Tirane, ne adresen: Rr. “Irfan Tomini”, Pallati pran shkollës Marin Barleti, Kati 7<sup>te</sup>, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportws biometrike numer BB6715786 dhe numer personal I31111085D.

**NENI 2**

**Personaliteti juridik**

1. Shoqëria “RSN CONSTRUCTION” SHPK, nga këtu e mëposhtë referuar si shoqëria, e fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).
2. Shoqëria është person juridik shqiptar e cila zhvillon aktivitetin në përputhje me ligjin nr. 9901 dt 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare” dhe këtë Statut.

**NENI 3**

**Objekti i aktivitetit**

Objekti i aktivitetit të shoqërisë do të jetë:

1. Ndërtim, ngritje, lartësim, rikonstruktim, shndërrim i çdo lloj ndertese per perdorim civil dhe industrial.
2. Prodhim dhe tregetim me shumice e pakice, import dhe eksport e te gjitha llojeve te materialeve te ndertimit, i makinerive e paisjeve per interes dhe llogari te vete shoqerise si dhe te te treteve.
3. Rregullim siperfaqesh, hapje mbyllje kanalesh, transe, shtrime dhe asfaltime, aplikim ne fushe te sinjalistikes rrugore dhe mirmbajtjes se tyre si dhe çdo punim tjetër te ngjashëm e te lejuar me ligj.
4. Projektim dhe zbatim i ndertimeve hidraulike dhe hidroteknike, ndertim ujesjellesash, kanalizime, kanale, impiante te stacioneve te pompimit dhe filtrimit si edhe stacioneve te grumbullimit dhe rigjenerimit te ujrave te zeza. Ndertim i impianteve te trajtimit te ujit.
5. Realizim i punimeve mbrojtjeje te sistemit hidraulik, çimentime, ndertime digash, galerish, tunelesh, apo te tjera punime te kesaj natyre si edhe ndertim impiante te trajtimit te ujit.
6. Projektim, pajisje, kompletim, realizim, venje ne pune dhe shfrytezim te linjave elektrike, te telekomunikacionit dhe transmetimit të të dhënave, i veprave te karakterit energjitik dhe te telekomunikacionit.

7. Projektim, pajisje, kompletim, realizim, venje ne pune dhe shfrytezim i impianteve, hidro centraleve, impianteve eolike, impianteve djellor per perfitim energjie, bokse elektrike, stacione e nen stacione elektrike, linja te transmetimit, e te matjes se energjise se konsumuar.
8. Prodhim parafabrikatesh, elementesh te gatshem, skela e bazamante te realizuar si elemente baze ose ndihmes.
9. Te perfitoje nepermjet blerjes ose me çdo menyre tjeter ligjore si dhe te zoteroje çfaredo shpikje, permiresim, ripunim, aplikimi, shenje tregtare, leje, marka, tipe, e te tjera te ngjashme.
10. Te bleje, te perdore, te zoteroje, te mbajte peng ose te shese apo te dhuroje pjese te pronesise, pune, te drejta, privilegje, konçensione, makineri, patenta, instalime, mallra tregtare apo çdo lloj tjeter pronesie te luajtshme e te paluajtshme e gjykuar me interes për shoqërinë.
11. Te bashkerendohet dhe te bashkohet me kushdoqofte tjeter shoqeri apo ndermarrje qe qe ka objekte te njejta me objektet e kesaj shoqerie.
12. Te lidhe kontrata me cilendo qeverisje qëndrore apo vendore dhe institucione te tjera publike dhe private qe mendon se do te dukeshin me interes per t'i sherbyer qellimit dhe objektit qe ka shoqeria.

#### **NENI 4**

##### **Selia e shoqërisë**

Shoqëria ka selinë e saj në adresën: Shoqëria ka selinë e saj qëndrore në adresën: **Tiranë, rruga "Lidhja e Prizrenit", Pallati 12, Shkalla B, Apartamenti Nr10.**

#### **NENI 5**

##### **Kohëzgjatja e shoqërisë**

1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është për një periudhë kohore të pakufizuar. Shoqëria fiton personalitetin juridik dhe mund të filloj veprimtarinë e saj pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
2. Çdo ndryshim në lidhje me periudhën e aktivitetit mundet të bëhet vetëm nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë.

#### **NENI 6**

##### **Të dhënat në korrespondencat dhe dokumentet e tjera të veprimtarisë**

Të gjitha shkresat, formularët e urdhrave apo çdo dokument tjetër korrespondence, nxjerrë nga shoqëria, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë të dhënat e mëposhtme:

- a) numrin unik të identifikimit (NUIS);
- b) formën ligjore të shoqërisë;
- c) vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qëndrore të saj;
- d) të dhëna nëse shoqëria është në likuidim.
- e) Nëse shoqëria ka faqe interneti, këto të dhëna duhet të pasqyrohen aty.



#### **NENI 7**

##### **Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është **ALL 100 000,00 (një qind mijë lekë).**

Kapitali i shoqërisë është i ndarë në **3 (tre)** pjesë, ndarë midis ortakeve si vijon:

- 1) **Ardit RAKIPI**, zotëron **1 (një)** pjesë në kapital me vlerë të përgjithshme **ALL 50,000** (pesëdhjet mijë lekë) që përbën **50%** të kapitalit të shoqërisë.
- 2) **Flamur SALIJA**, zotëron **1 (një)** pjesë në kapital me vlerë të përgjithshme **ALL 40,000** (dyzet mijë lekë) që përbën **40%** të kapitalit të shoqërisë.
- 3) **Erjon NITO**, zotëron **1 (një)** pjesë në kapital me vlerë të përgjithshme **ALL 10,000** (dhjet mijë lekë) që përbën **10%** të kapitalit të shoqërisë.





## **NENI 8**

### **Regjistrimi i kuotave**

Pronësia mbi kuotat dhe veprimet me to regjistrohen në regjistrin që shoqëria mban për këtë qëllim dhe që përmban detyrimisht të dhënat e mëposhtme:

- a) emrin, mbiemrin, numrin e pasaportës dhe adresën e pronarit të kuotës;
- b) vlerën e përgjithshme që perben përqindjen ndaj kapitalit themeltar të shoqërisë dhe numrin e kuotave në pronësi;
- c) emrin, mbiemrin, numrin e pasaportës dhe adresën e pronarit të ri të kuotës në rast transferimi;
- d) të dhënat e kontratës me të cilën është bërë transferimi i pronësisë mbi kuotën.

## **NENI 9**

### **Transferimi i kuotave midis ortakëve**

Kuotat e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme midis ortakëve.

## **NENI 10**

### **Transferimi i kuotave me trashëgimi dhe te personat familjar**

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarje pasurore midis bashkëshortëve si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.
2. Kuotat e kapitalit të shoqërisë mundet të transferohen lirisht midis prindit dhe fëmijës ose anasjelltas.

## **NENI 11**

### **Kalimi i kuotave tek të tretët dhe e drejta e parablerjes**

1. Transferimii kuotave të kapitalit jashtë rrethit të ortakëve kushtëzohet nga e ushtrimi i së drejtës së parablerjes së ortakëve.
2. Nëse ndonjë nga ortakët vendos të transferojë një pjesë apo të gjithë kapitalin themeltar që i përket atij tek të tretët të cilët nuk janë bashkëshorti apo trashëgimtarët e drejtpërdrejtë (për këtë qëllim trashëgimtarë të drejtpërdrejtë do të quhen prindërit, fëmijët, vëllezërit dhe motrat) ai detyrohet të respektojë të drejtën e parablerjes, duke ia ofruar më parë kuotat ortakut(ëve) të tjerë të shoqërisë. Oferta përpilohet para noterit dhe i njoftohet ortakëve të tjerë nëpërmjet postës së porositur (rekomande) dhe duhet të përmbajë pjesën e kapitalit themeltar që do të transferohet, çmimin e kërkuar për të dhe periudhën kohore brenda të cilës oferta është e vlefshme, në mënyrë që ortakët e tjerë të ushtrjnë të drejtën e blerjes apo të refuzojnë ofertën.
3. Secili ortak e gëzon të drejtën e parablerjes për të blerë kuotën përpjesëtimisht me pjesëmarrjen e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
4. E drejta e parablerjes do të ushtrohet brenda një periudhe 1 (një) mujore, duke filluar nga data në të cilën oferta i është njoftuar Asamblesë së Përgjithshme dhe/ose secilit prej ortakëve. Nëse ortakët nuk e ushtrjnë të drejtën e parablerjes brenda kufijve kohorë, shitësi i kuotës ka të drejtën të transferojë kuotën e tij tek të tretët.

## **NENI 12**

### **Organet e shoqërisë**

Drejtimi dhe administrimi i shoqërisë bëhet nëpërmjet organeve të saj që janë:

1. Administratori.
2. Asambleja e Përgjithshme.

## **NENI 13**

### **Administratori**

1. Asambleja e Përgjithshme emëron një person fizik si Administrator të Shoqërisë, sipas Nenit 81 paragrafi (1) pika 3 dhe nenit 95 të Ligjit.



2. Shoqëria administrohet nga administratori i cili ka për detyrë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të Shoqërisë.
3. Shoqëria do të drejtohet për një periudhë 3 (tre) vjeçare, nga Administratori, shtetasi:  
**Erjon NITO**, atesia Aleksandër, i lindur me 11.11.1983, ne Kutalli, Berat dhe banues ne Tirane, ne adresen: Rr. "Irfan Tomini", Pallati pran shkollës Marin Barleti, Kati 7<sup>te</sup>, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i numerit personal I31111085D. Email: [erion-nito@hotmail.com](mailto:erion-nito@hotmail.com). Cel: 069 673 66 55.

#### **NENI 14**

##### **Emërimi i administratorit**

1. Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
2. Administratori është person fizik i cili mund të zgjidhet edhe jashtë bashkësisë së ortakëve të shoqërisë.

#### **NENI 15**

##### **Kohëzgjatja e mandatit**

1. Akti për emërimin e administratorit përcakton gjithashtu dhe kohën e qëndrimit në detyrë të tij. Nëse kjo nuk është e përcaktuar në aktin e emërimit, kjo periudhë nuk mundet të jetë më e gjatë se pesë vjet, duke filluar ky afat nga data e emërimit.
2. Në rast dorëheqje/shkarkimi Asambleja e Përgjithshme, jo më vonë se 2 javë nga momenti i njoftimit të dorëheqjes ose shkarkimit, emëron me vendim Administratorin e ri të shoqërisë.

#### **NENI 16**

##### **Kompetencat e Administratorit**

1. Administratori ka kompetenca të plota për të vepruar në çdo rrethanë në emër të shoqërisë, gjithmonë brenda objektit të aktivitetit të shoqërisë, duke u kufizuar në ato kompetenca që ligji ose ky Statut ia jep shprehimisht Asamblesë së Përgjithshme.
2. Administratori i shoqërisë ka këto të drejta dhe detyrime:
  - a) përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët,
  - b) kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë; duke zbatuar politikatat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
  - c) vendos për hapjen e selive dytësore;
  - d) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - e) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
  - f) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - g) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - h) raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.
3. Shitja dhe/ose blerja e pasurive të paluajtshme do të konsiderohet evlefshme nëse për të është marrë pëlqimi paraprak i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Në këtë rast vendimi përkatës i Asamblesë do të konsiderohet i vlefshëm, nëse ortakët që përfaqësojnë të paktën 51% të kapitalit të shoqërisë, kanë votuar në favor të shitjes dhe/ose blerjes së pasurisë në fjalë.
4. Administratori kryen pagesa/transferta, sipas nevojës së kompanisë.

---



5. Administratori përgjigjet për ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve të shoqërisë, duke përfshirë vendimet dhe procesverbalet e Asamblesë së Përgjithshme.

**NENI 17**


**Asambleja e Përgjithshme**

1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë.
2. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet e mëposhtme:
  - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
  - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i) shitjen e pasurive të paluajtshme të shoqërisë;
  - j) blerjen e pasurive të paluajtshme të shoqërisë;
  - k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
3. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat “e” dhe “ë” të pikës 2 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.
4. Në rastin e zotërimit të kapitalit nga vetëm një ortak, funksionet e asamblesë së përgjithshme i ushtron ortaku i vetëm i shoqërisë i cili shprehet me vendim.

**NENI 18**

**Thirrja e mbledhjes së asamblesë**

1. Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligji ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.
2. Mbledhja e asamblesë thirret nga administratori ose likuiduesi/t.
3. Pavarësisht nga sa përcaktohet në paragrafin e mësipërm, ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në Asamblenë e Përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur Asamblenë e Përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, duke respektuar rregullat që ligji dhe ky statut parashikon edhe për thirrjen e asamblesë nga Administratori.
4. Nëse, në kundërshtim me paragrafin 2 të këtij neni, Asambleja e Përgjithshme nuk thirret ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës secili prej ortakëve që kanë bërë kërkesën ka të drejtë:
  - a) të ngrëjë padi në gjykatë, për të deklaruar shkëljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përmbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;
  - b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.



5. Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e nenit 20 të Statutit.

#### **NENI 19**

##### **Mënyra e njoftimit**

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës, e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Bashkë me njoftimin ortakëve u duhet dërguar edhe dokumentacioni që ka lidhje me rendin e ditës.
2. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### **NENI 20**

##### **Përfaqësimi i një ortaku**

1. Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi, nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
2. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.
3. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **NENI 21**

##### **E drejta e votës**

1. E drejta e votës ushtrohet dhe numri i votave llogaritet në përpjesëtim me pjesëmarrjen në kapital.
2. Ortakët që nuk janë të pranishëm mund të marrin pjesën e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike.
3. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:
  - a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;
  - b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër;
  - c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.
4. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

#### **NENI 22**

##### **Përfshirja nga e drejta e votës**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për:
  - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.



### **NENI 23**

#### **Kuorumi**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kapitalit.
2. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas këtij Statuti, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.
3. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur në pikën 1 e 2 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### **NENI 24**

#### **Marrja e vendimeve**

1. Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Për çështjet e tjera të renditura në nenin 17 të këtij Statuti, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe në këtë statut.

### **NENI 25**

#### **Modalitetet e zmadhimit të kapitalit**

1. Kapitali themeltar zmadhohet në mënyrën e përcaktuar në ligj.
2. Në rastin e kontributeve në natyrë, vlerësimi i tyre bëhet prej një ose më shumë ekspertëve për kontributet të caktuar me vendim nga gjykata në bazë të kërkesës së bërë nga Administratori i shoqërisë.
3. Raporti i ekspertit/ekspertëve të kontributeve vihet në dispozicion të ortakëve në selinë e shoqërisë.

### **NENI 26**

#### **Modalitetet e zvogëlimit të kapitalit**

1. Zvogëlimi i kapitalit i prek ortakët në të njëjtën masë në përpjesëtim me vlerën e kuotave që zotërojnë.
2. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, të paktën 45 ditë përpara mbledhjes së asamblesë së ortakëve që thirret për të vendosur mbi këtë projekt.
3. Asambleja merr vendim mbi raportin e ekspertëve kontabël të autorizuar, të cilët japin vlerësimin e tyre mbi shkaqet dhe kushtet e zvogëlimit.

### **NENI 27**

#### **Eksperti kontabël i autorizuar**

1. Asambleja mund të vendosë që kontrolli i shoqërisë të ushtrohet nga një ekspert kontabël i autorizuar.
2. Eksperti kontabël të autorizuar emërohen për një vit financiar. Funkcionet e tij / tyre përfundojnë pas mbledhjes së asamblesë e cila merr vendim mbi llogaritë vjetore.
3. Eksperti kontabël i autorizuar, i emëruar nga asambleja për zëvendësimin e një tjetri, mbetet në funksion deri në fundin e mandatit të paraardhësit të tij.
4. Eksperti kontabël i autorizuar është përgjegjës si ndaj shoqërisë, ashtu dhe ndaj të tretëve për pasojat e dëmshme që rrjedhin nga fajet dhe nënvleftësimet në ushtrimin e funksioneve përkatëse.
5. Eksperti kontabël i autorizuar, nuk është ligjërisht përgjegjës për shkeljet e ligjit të kryera nga Administratori, me përjashtim të rasteve kur ka pasur dijeni për to, por nuk i ka zbuluar në raportin për

mbledhjen e asamblesë.



#### NENI 28

#### Shpërndarja e fitimeve të shoqërisë

1. Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.
2. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

#### NENI 29

#### Kufizimet e shpërndarjeve - Çertifikata e aftësisë paguese

1. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:
  - a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
  - b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.
2. Administratorët lëshojnë një çertifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 1 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë çertifikatë.
3. Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e çertifikatës së aftësisë paguese.

#### NENI 30

#### Prishja e shoqërisë

Shoqëria do priset:

- a) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- b) me hapjen e përfundimin e procedurave të falimentimit/likuidimit;
- c) në raste të parashikuara nga ligji në fuqi ;
- c) me vendim të gjykatës;

#### NENI 31

#### Likuidimi i shoqërisë

Likuidimi i shoqërisë kryhet në përputhje dhe në respektim të kushteve dhe procedurave të parashikuara nga dispozitat përkatëse ligjore.

#### NENI 32

#### Fuqia e akteve

Të gjitha çështjet për të cilat Statuti nuk i rregullon në mënyrë të posaçme do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare" të cilat parashikojnë mënyrën e organizimit, funksionimit dhe kontrollit të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

#### ORTAKET THEMELUES TË SHOQERISE TREGTARE

«RSN CONSTRUCTION» Sh.p.k

1. Ardit RAKIPI

2. Flamur SALIJA

3. Erjon NITO

*Ardit Rakipi*

*Flamur Salija*

*Erjon Nito*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER EDLIRA S. HYSENI



DATE 27/05/2020  
NR REP 1181

V2020052950060451507



VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane, sot me date 27. 05. 2020 (dymije e njëzet) para meje Noterit Publik Edlira S. HYSENI, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, u paraqitën personalisht personat me keto identitete:

1. **Ardit RAKIPI**, atesia Karaman, shtetas shqiptar, i lindur me 12.05.1967, ne Peqin, dhe banues në adresën rruga “11 Janari” Peqin, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit numer 035090561 dhe numer personal G70512019G.
2. **Flamur SALIJA**, atesia Zelul, lindur me 16.07.1972, ne Carshove, Permet dhe banues ne Tirane, 1045 Selitë Lagjja nr 13, Rr “Eduart Mano” 38 / 1 / 6, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit numer 028807288 dhe numer personal H20716089I.
3. **Erjon NITO**, Aleksandër, i lindur me 11.11.1983, ne Kutalli, Berat dhe banues ne Tirane, ne adresen: Rr. “Irfan Tomini”, Pallati pran shkollës Marin Barleti, Kati 7<sup>te</sup>, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportys biometrike numer BB6715786 dhe numer personal I31111085D.

Me vullnetin e tyre të lire e të plote, personat më siper pershkruar kanë redaktuar jashte kesaj zyre me cilesine e Ortakëve Themelues te Shoqerise “RSN CONSTRUCTION” Sh.p.k. dokumentin bashkengjitur. Nënshkruesit deklarojnë se e kuptojnë tërësisht aktin bashkengjitur dhe pasojat e tij dhe akti u nenshkrua prej tyre pa verejtje duke shkruar emrin mbiemrin dhe firmen orgjinale ne kete zyre dhe para meje Noterit. Une Noteri vertetoj rregullesin dhe bazueshmerine e redaktimit ne ligj të ketij dokumenti si dhe autenticitetin e nenshkrimit, me cilesine qe me njeh Ligji nr. 110/2018 "Per Noterin" ne Republiken e Shqiperise”.

NOTERE  
Edlira S. HYSENI

